

Kreu i qeverisë Sali Berisha zhvilloi sot, një takim me Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotin Bujar Leskaj, të cilit i uroi zgjedhjen e tij në këtë post dhe suksese në realizmin e detyrës së tij.

Në fjalën e tij Kryeministri theksoi se lufta kundër korrupsionit dhe transparenca e qeverisjes janë gur themeli në një shtet demokratik. Duke e vlerësuar KLSH si një institucion themelor në këtë drejtim, Kryeministri theksoi se qeveria do të mbështesë punën e këtij institucioni. Kryeministri shprehu besimin se KLSH do të shqyrtojë gjithçka me rigorozitet dhe objektivitet maksimal në përputhje me ligjin, ndërsa theksoi se kontrolli të ketë si objektiv të gjitha institucionet si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor.

Ndër të tjera, Kryeministri theksoi se është e nevojshme dhe shumë e rëndësishme që veprimtaria e KLSH të përqendrohet në shtratin e saj ligjor që ia përcakton qartë Kushtetuta dhe ligjet. “Me punën tuaj, të përpqeni të forconi besimin e publikut tek këto institucione si dhe të përcillni një përgjegjshmëri sa më të lartë për zbatimin e ligjit” , u shpreh Kryeministri.